



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN / MUNICIPALITY OF LIPJAN



Drejtoria i Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Datë/Datum/ Date:	08.06.2026
Për/Za/For:	z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit
CC:	z. Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës z. Avni Jashari - Shef i Kabinetit të Kryetarit
Nga/Od/From	z. Rexhep Rexhepi - Drejtori i Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari
Lënda/Subjecat/Subject:	Raporti për muajin Maj

I nderuar Kryetar z. Imri Ahmeti,

Të bashkangjitur gjeni Raportin mujor të aktiviteteve të Drejtoratit të Bujqësisë për periudhën nga 01.05.2026 deri me 31.05.2026

Lipjan 2026

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

SEKTORI I BUJQËSIË

Gjatë muajit maj kemi zhvilluar takime me stafin, ku janë hartuar dhe planifikuar projektet e parapara për fillim të realizimit. Po ashtu, kemi realizuar disa projekte dhe aktivitete me qëllim të zhvillimit të sektorit bujqësor në komunën tonë.

Një ndër prioritetet tona ka qenë përmirësimi i shërbimeve për fermerët. Për këtë arsye, kemi bërë rritjen e stafit për pagesa direkte, me qëllim të eliminimit të pritjeve të gjata për fermerët që aplikojnë në këtë program dhe ofrimit të shërbimeve më të shpejta dhe më efikase.

Gjatë muajit maj kemi nisur procedurat për blerjen e mekanizmit bujqësor për fermerët që janë në listën e pritjes për freza dhe spërkatëse për traktorë.

Po ashtu, gjatë muajit prill është mbyllur afati për aplikim për fermerët e sektorit blegtor në kuadër të subvencionimit të qumështit. Në këtë thirrje publike kanë aplikuar 57 fermerë, me sasi të përgjithshme prej rreth 1,146,903.00 litra qumësht, në vlerë prej 45,876.12 euro. Ky subvencion do të jetë një ndihmë shumë e madhe për fermerët blegtorë të Komunës sonë.

Gjithashtu, gjatë muajit maj kemi zhvilluar takim me përfaqësuesit e organizatës TIKA me qëllim të fillimit të bashkëpunimit në sektorin e bujqësisë. Në kuadër të këtij bashkëpunimi kemi diskutuar mundësinë e furnizimit me mekanizëm të rëndë bujqësor, projekt të cilin synojmë ta realizojmë gjatë pjesës së dytë të vitit.

Komisioni komunal, gjatë muajit maj, ka kompletuar lëndët e fermerëve të dëmtuar nga vërshimet dhe të njëjtat janë dërguar në AME, me qëllim të mbulimit të dëmeve të shkaktuara nga vërshimet gjatë muajit janar të këtij viti.

Gjithashtu, kemi vazhduar trajtimin e qenve endacakë sipas kërkesave të banorëve në lagje dhe lokacione të ndryshme të komunës. Varësisht nga kërkesat, jemi munduar të jemi prezent në secilin lokacion për të trajtuar këtë problematikë.

Përveç kësaj, gjatë muajit maj, me ftesë të organizatës ndërkombëtare Four Paws dhe një fondacioni për mbrojtjen e kafshëve, kemi marrë pjesë në një punëtori dyditore lidhur me menaxhimin e qenve endacakë. Gjatë kësaj punëtorie kemi parë nga afër praktikën e vendeve të zhvilluara dhe shpresojmë që të gjejmë modalitete për t'i zbatuar këto praktika edhe në komunën tonë, me qëllim të trajtimit më të mirë të qenve endacakë dhe uljes së numrit të tyre në qytet dhe vendbanime të tjera.

Muaji maj ka qenë me shumë aktivitete dhe angazhime, duke realizuar me sukses objektivat tona të parapara për këtë periudhë.